



VENDIM

Nr. 64 Date 22 .09. 2009

PËR

**SHTYRJEN E AFATIT PËR REALIZIMIN E KUSHTEVE TE VENDOSURA
NGA ERE SHOQËRISË UNION EOLICA ALBANIA SH.P.K**

Në mbështetje të neneve 9, 13 pika 1, gërma “a”, dhe 15 të Ligjit Nr.9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, neneve 121 dhe 128 të Ligjit nr.8485, datë 12.05.2008 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 22.09.2009, mbasi shqyrtoi informacionin e Drejtorise se Licensimit dhe Monitorimit te Tregut për shtyrjen e afateve për realizimin e kushteve të vendosura nga ERE shoqërisë Union Eolica Albania sh.p.k,

Dhe duke konsideruar :

Kompleksitetin e problemtikes që i licensuari ka hasur për kryerjen dhe dorëzimin e studimit të fizibilitetit të bazuar në matje reale dhe duke qënë se ndërtimi dhe instalimi i parqeve eolik përveç etapave administrative në të cilat kalon çdo projekt përbën akoma një teknologji jo shumë të njohur në vend dhe që kërkon asistencen teknike të huaj,

Vendosi:

1. Të shtyjë me 12 muaj duke filluar nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi afatet e përcaktuara në pikën 1, gërma “a”, dhe “d”, të Vendimit nr.88 datë 06.08.2008 “Për licensimin e Shoqërisë Union Eolika Albania sh.p.k”.
2. Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit te Tregut të njoftojë shoqërinë për Vendimin e Bordit të Komisionereve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.



Votimi i Bordit të Komisionerëve të ERE-s për,

VENDIMIN

Nr. 64 Date 22 .09. 2009

PËR

**SHTYRJEN E AFATIT PËR REALIZIMIN E KUSHTEVE TE VENDOSURA NGA
ERE SHOQËRISË UNION EOLICA ALBANIA SH.P.K**

Anëtarët e Bordit

	Pro	Kundër
Bujar Nepravishta	_____	_____
Entela Shehaj	_____	_____
Ardian Haçi	_____	_____
Abaz Aliko	_____	_____
Shkëlqim Bozgo	_____	_____